



Konrad
Adenauer
Stiftung

Sytrime Dervisholli

Manuali për Investitorët e huaj



Manuali për investorët e huaj

Sytrime Dervisholli

2017

Impresumi

Titulli:

Manuali për investitorët e huaj

Botues: Fondacioni-Konrad-Adenauer në Republikën e Kosovës

Autore: Sytrime Dervisholli

Koordinimi: Johannes D. Rey

Printimi dhe Dizajni: Shtypshkronja A1

Punimi mund të shkarkohet në:

<http://www.fkas.de/Kosovo>

Pikëpamjet e paraqitura në këtë manual janë pikëpamjet personale të autores dhe nuk paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Konrad-Adenauer, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe/ose Qeverisë së Republikës së Kosovës.
--

Dervisholli, Sytrime

Manuali për investitorët e huaj/ Sytrime Dervisholli - Prishtinë: Fondacioni-Konrad-Adenauer, 2017. – 53 f. - Referenca: f. 51 - 53

Tabela e përmbajtjes

Përshkrim i ekonomisë – Kosova në shifra.....	7
Treguesit kryesor ekonomik.....	8
Investimet e huaja direkte në rajonin e Ballkanit dhe në Kosovë.....	10
Pse të investohet në Kosovë?.....	12
Incentivat për investime.....	14
Procedurat e regjistrimit të biznesit.....	17
Tatimet dhe tarifat doganore.....	18
Mbrojtja e investitorëve.....	22
Marrëveshjet.....	23
Mjedisi afarist.....	23
Regjimi tregtar.....	25
Importet dhe eksportet 2010-2016.....	26
Tregtia në Shërbime.....	29
Legjislacioni.....	30
Ligji i punës.....	31
Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.....	33
Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme.....	33
Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.....	34
Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.....	34
Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale.....	35
Transporti rrugor.....	36
Transporti hekurudhor.....	36
Transporti ajror.....	36
Diaspora e Kosovës.....	36
Sektori bankar në Kosovë.....	38
Fuqia punëtore dhe tregu i punës në Kosovë.....	39
Zonat Ekonomike në Kosovë.....	43
Platforma e dialogut në mes Qeverisë dhe Investitorëve.....	45
Storie të suksesit dhe dështimit.....	47

Pengesat gjatë procesit të investimit në Kosovë	48
Kontaktet me rëndësi	49
Referencat	51

Grafikonet

Grafikoni 1: Investimet e huaja direkte në Kosovë.....	11
Grafikoni 2: Eksportet e Kosovës 2010-2016.....	28
Grafikoni 3: Importet e Kosovës 2010-2016.....	28
Grafikoni 4: Bilanci tregtar i shërbimeve 2012-2016.....	29
Grafikoni 5: Sektorët e shërbimeve me potencial zhvillimi.....	30
Grafikoni 6: Dërgesat e emigrantëve.....	38
Grafikoni 7: Punëkërkues të regjistruar sipas kualifikimeve.....	40

Tabelat

Tabela 1: Treguesit e zgjedhur makroekonomik	9
Tabela 2: Rritja ekonomike e vendeve të rajonit.....	10
Tabela 3: Investimet e huaja direkte në rajonin e Ballkanit	10
Tabela 4: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore.....	17
Tabela 5: Degët e kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë	18
Tabela 6: Sistemi i tatimeve në rajon (TVSH&TAK) – 2015.....	20
Tabela 7: Rangimi i Kosovës në Doing Business 2017	24
Tabela 8: Krahësimi i indikatorëve 2016-2017	24
Tabela 9: Tregtia sipas grup vendeve.....	27

Tabela 10: Eksportet e Kosovës në pjesën e mbetur të botës	27
Tabela 11: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2012-2016	29
Tabela 12: Dërgesat e emigrantëve, sipas shteteve	38
Tabela 13: Numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës sipas viteve	40
Tabela 14: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë	41
Tabela 15: Punësimi sipas nivelit arsimor	41
Tabela 16: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhënësit (15-64)	42
Tabela 17: Profesionet e të punësuarve sipas gjinisë	42

Shkurtesat

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
API	Agjencia për Pronësi Industriale
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
AKS	Agjencia Kosovare e Standardizimit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IHD	Investimet e Huaja Direkte
KES	Këshilli Ekonomik Social
KIESA	Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
KIE	Këshilli i Investitorëve Evropian
KKI	Këshilli Kombëtar për Investime
KKZHE	Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
SKZH	Strategjia Kombëtare për Zhvillim

Përshkrim i ekonomisë – Kosova në shifra

Rregullimi Kushtetues i ekonomisë së Republikës së Kosovës bazohet në parimet e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë. Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë regjim tregtar liberal që bazohet në parimet e ekonomisë së tregut, me konkurrencë të lirë e që favorizon hapjen e tregjeve, si e vetmja mundësi për ngritje të qëndrueshme të aftësisë konkurruese.

Republika e Kosovës ndodhet në një fazë të rëndësishme kur duhet të orientohet agjenda zhvillimore drejt integritimeve evropiane në të gjitha fushat. Një orientim i tillë zhvillimor evropian vjen natyrisht pas tejkalimit të fazës së emergjencës dhe stabilizimit gjatë viteve 1999-2007, dhe fazës së shtet ndërtimit në periudhën pas shpalljes së pavarësisë.¹

Është e nevojshme që strategjitë dhe politikat ekzistuese të integrohen dhe të krijohet një bosht i përbashkët orientues. Ndërkohë, që një politikë e mirëfilltë zhvillimore e shtetit kërkon që ato të ndërveprojnë jo vetëm në koherencë ndërmjet tyre, por edhe që të ngushtohet fokusi i masave të shumta të tyre, duke përzgjedhur "prioritetet më të larta të vendit".

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021) është pikërisht kjo listë e prioritetëve të larta. Ky është një dokument i cili ka për synim që t'i adresojë pengesat kryesore për zhvillimin e Kosovës. Krijimi i një dokumenti të tillë ka për pikënisje faktin se një prej pengesave kryesore për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë është vetë koordinimi i politikave zhvillimore dhe proceseve institucionale, të identifikuar nga studime të ndryshme të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.²

Dihet që investimet e huaja luajnë një rol kyç në inkurajimin dhe përkrahjen e një tranzicioni të suksesshëm. Investimet e huaja në ekonominë tranzicionale duket të jenë një mjet efektiv për disa arsye si: potenciali për rritjen e investimeve, transferi i dijes, rritja e produktivitetit, përmirësimi i aftësisë menaxheriale dhe fuqisë punëtore dhe përmirësimi i bilancit tregtar. Edhe pse të gjitha vendet që kalojnë nëpër fazën e tranzicionit kanë pak a shumë të njëjtin qëllim, rezultatet e përpjekjeve të tyre dallojnë. Kjo është për shkak kushteve të ndryshme të brendshme dhe të jashtme që secili vend përballlet me to dhe për

¹ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018

² Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021)

shkak të strategjive dhe politikave që ato ndërmarrin për të siguruar tranzicion të qetë dhe të suksesshëm.

Interesat kryesore të investitorëve të huaj janë rritja e fitimit, konkurrueshmëria dhe qasja në tregjet ndërkombëtare. Interesi kryesor i vendeve në zhvillim është nxitja e rritjes ekonomike në vend.

Orientimet strategjike të platformës për promovim të investimeve kanë të bëjnë me fuqizimin e sektorit privat dhe nxitjen e investimeve, duke përfshirë investimet e huaja direkt. Institucionet në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), siç janë Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare (ARBK), Agjencia e Standardizimit të Kosovës (ASK) do të jenë në funksion të përmbushjes së këtyre orientimeve strategjike. Në këtë drejtim do të shfrytëzohen edhe potencialet e Ministrisë së Diasporës, e sidomos rrjetet e biznesit që i ka krijuar në diasporë. Për të arritur këtë Qeveria e Kosovës gjatë këtij mandati do të fokusohet në:

- Shfrytëzimin e rritjes së madhësisë së tregut, si rrjedhojë e zbatimit të MSA-së, për promovim të investimeve strategjike në ekonomi;
- Kryerjen e studimeve dhe analizave për përparësitë konkurruese në sektorë të caktuar të ekonomisë dhe aplikimin e masave stimuluese në këta sektorë;
- Përgatitjen dhe zbatimin e trajnimeve profesionale në të gjithë sektorët, regjionet dhe ndërmarrjet me potencial konkurrues, me theks të veçantë përmes mekanizmave të Fondit për Investim dhe Punësim;
- Vazhdimin e dinamikës në reformën e të bërit biznes, sidomos nëpërmjet reformave konkrete që mundësojnë siguri të qartë juridike për investitorët.

Treguesit kryesor ekonomik

Me 29 Qershor 2009, Kosova është anëtarësuar në Bankën Botërore dhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Zhvillimi i vërtetë i ekonomisë matet me produktin e brendshëm bruto (PBB) që ka qenë e favorshme në vitet e fundit, duke treguar një trend pozitiv dhe vazhdimisht në rritje. Pavarësisht efekteve të krizës financiare ndërkombëtare, Kosova ishte një nga vendet e pakta në Europë që përjetoi rritje ekonomike pozitive në vitet e

fundit. Pasi që mbështetja nga donatorët po zvogëlohet, konsumi i sektorit privat dhe investimet po bëhen faktorët më të rëndësishëm që po ndikojnë në rritjen ekonomike. Këto investime janë kryesisht duke u nxitur nga zgjerimi i shpejtë i sektorit financiar. Për më tepër, Qeveria e Kosovës ka një politikë fiskale stabile. Baza e të ardhurave tatimore është zgjeruar duke mundësuar rritjen e shpenzimeve qeveritare dhe si kthim i kësaj të mbështesë rritjen ekonomike. Përveç performancës së mirë ekonomike, Kosova ka një politikë monetare stabile. Kosova është një prej vendeve jashtë zonës së BE-së që ka në përdorim valutën e Euros, si valutë zyrtare. Përdorimi i Euros ka siguruar inflacion të ulët dhe mjedis stabil makroekonomik.³

Ekonomia e Kosovës u karakterizua me rritje të aktivitetit gjatë vitit 2016 kundrejt vitit paraprak. Sipas statistikave preliminare të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për BPV-në tremujore, rezultojnë se ekonomia e Kosovës shënoi rritje mesatare përgjatë katër tremujorëve të vitit 2016 prej 3.4 përqind. Rritja ekonomike gjatë vitit 2016 u mbështet nga rritja e kërkesës së brendshme, përdërisa neto eksportet ndikuan negativisht në normën e rritjes ekonomike. Gjatë vitit 2016, ishin rritja e investimeve prej 9.1 përqind si dhe rritja e konsumit prej 3.0 përqind që kontribuan në rritjen reale të ekonomisë së vendit. Sipas qasjes së prodhimit, rritja ekonomike gjatë vitit 2016 ishte kryesisht rezultat i rritjes së vlerës së shtuar të aktivitetit në sektorin e bujqësisë, tregtisë dhe aktiviteteve financiare. Ndërsa, rënie reale vlerësohet të jetë shënuar tek afarizmi me pasuri të patundshme, industria përpunuese dhe administrimi publik.⁴

Tabela 1: Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2014	2015	2016
GDP (në milion Euro)	5,391.8	5,795.5	6,043.1
Papunësia	35.3%	32.9%	27.5%
Remitencat (në milion Euro)	622.3	665.5	691.0

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës – buletini mujor statistikor, Tetor 2017

Tabela më poshtë tregon rritjen ekonomike për vitin 2016 dhe projeksionet për vitin 2017 dhe 2018 si dhe krahasimi me vendet e rajonit, sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar.

³ Sytrime Dervisholli "Opportunities to Foreign Investment in Kosovo", September 2011

⁴ Raporti vjetor i BQK (2016) - https://bqk-kos.org/repository/docs/2017/BQK-RV-2016_shqip.pdf

Tabela 2: Rritja ekonomike e vendeve të rajonit, në %

Vendi	2016	2017	2018
Shqipëria	3.40	3.70	4.11
Bosnja dhe Hercegovina	3.00	3.20	3.70
Kroacia	1.90	2.10	2.20
Kosova	4.05	3.34	3.64
Maqedonia	2.20	3.50	3.50
Mali i Zi	5.08	3.63	2.44
Serbia	2.50	2.80	3.50

Burimi: FMN, Report for selected countries and subjects

Investimet e huaja direkte në rajonin e Ballkanit dhe në Kosovë

Në Evropën Jug-lindore, rritja e investimeve të huaja direkte (IHD) ka qenë kryesisht nga investitorët evropian. IHD në rajon kanë qenë kryesisht të drejtuara në industrinë prodhuese, si në ushqim dhe cigare, kimikate, tekstil dhe veshje, industria automobilistike dhe farmaceutike. Fluksi i IHD-ve është rritë në Serbi dhe Mal të Zi, përderisa në Shqipëri ka mbetë në nivelin e 1 miliard dollar. Në Bosnje dhe Hercegovinë fluksi i investimeve ka rënë në 3 vitet e fundit. Përderisa, vendet e euro zonës (Austria, Holanda, Greqia dhe Italia) janë investitorët më të rëndësishëm në rajon ndërsa, investitorët nga Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Kina janë duke u rritur me shpejtësi.⁵

Tabela 3: Investimet e huaja direkte në rajonin e Ballkanit (2014-2016), \$ milion

Vendi	2014	2015	2016
Shqipëria	1,110	945	1,124
Bosnja dhe Hercegovina	529	270	285
Maqedonia	272	240	397
Mali i Zi	497	699	226
Serbia	1,996	2,347	2,229


Burimi: UNCTAD World Investment Report 2017

Duke marrë parasysh klimën e favorshme të biznesit, mjedisin stabil makroekonomik dhe mundësitë e mira nëpër sektorë të ndryshëm biznesor, Kosova është duke u bërë edhe më tepër një vend atraktiv për të bërë biznes. Si rezultat, interesi i investitorëve të huaj është

⁵ UNCTAD World Investment Report 2017

duke u rritur ndër vite. Kosova ka tërhequr rreth 3 miliard Euro në 10 vitet e fundit (2006-2016). Pas një kulmi në vitin 2007 me 440 milion Euro, kjo si rezultat i procesit të privatizimit, një rënie e lehtë ndodhi në vitin 2008 dhe 2009, kryesisht për shkak të krizës globale financiare. Në vitin 2015 në Kosovë kishte rritje pozitive të IHDve me 324.4 milion Euro përderisa vlera e IHDve në vitin 2016 ishte 215.9 milion Euro që paraqet nivel më të ulët krahasuar me vitin 2015. Përveç pionierëve si Raiffeisen Bank dhe Procredit, të cilat kanë hy në tregun Kosovar në fillim të fazës tranzicionale, është një numër i kompanive të huaja që janë të përfshira në një gamë të gjerë të sektorëve të biznesit. Sipas të dhënave të regjistrimit të bizneseve, janë 4,634 kompani me pronësi të huaj dhe miks që tashmë kanë investuar në Kosovë. Numri i madh i kompanive të huaja që operojnë në Kosovë janë dëshmi e gjallë për mundësitë dhe përfitimet që Kosova ofron.

Grafikoni 1: Investimet e huaja direkte në Kosovë, 2006-2016 (C milion)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës/Raporti vjetor 2016

IHD-të në Kosovë janë të përqendruara në sektorët si patundshmëria (58 përqind të gjithshëj IHD-ve), shërbimet financiare (20 përqind), ndërtimtaria (14 përqind), dhe industria (7 përqind). Në vitin 2016, pothuajse të gjithë sektorët janë karakterizuar me rënie sa i përket pranimin të IHD-ve. Vlera e investimeve në patundshmëri ishte më e ulët për 21.9 milionë Euro krahasuar me vitin 2015, investimet në sektorin financiar ishin më të ulëta për 45.4 milionë Euro. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Zvicra paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në vitin 2016 (61.8 milionë Euro), pasuar nga Turqia me

44.4 milionë Euro, Gjermania me 25.7 milionë Euro, Shqipëria me 28.6 milionë Euro, SHBA me 22.6 milionë Euro etj.⁶

Pse të investohet në Kosovë?

Mjedisi afarist në Republikën e Kosovës është duke u bërë ndër më konkurruesit në rajon. Përparësitë e krijuara sikurse janë sistemi i shkëlqyer tatimor, burimet e bollshme natyrore, regjistrimi i shpejtë dhe i lehtë i bizneseve, ligjet transparente mbi investimet e huaja dhe përparësitë tjera e bëjnë Kosovën një mjedis atraktiv dhe të favorshëm për investorët e huaj.

Republika e Kosovës shquhet si vendi me mundësi të mëdha për investime në Ballkan, pra një arsye e fortë tërheqëse për investorët ndërkombëtarë si një vend primar për investimet e tyre.⁷

- Kostoja më e ulët e punës në Evropë
- Posedojnë aftësi të shumta, flasin shumë gjuhë dhe ka kosto efektive
- Euro është monedhë zyrtare
- Qasje të lirë në tregun e BE-së, SHBA-së dhe vendet e CEFTAs
- Popullsia më e re në Evropë
- Situata politike stabile
- Legjislati i është në përputhje me atë të BE-së
- Vend strategjik me infrastrukturë në zhvillim
- Sistemi i shëndoshë bankar
- Mosha mesatare e popullsisë – 27 vjeç
- Gjuha angleze dhe gjuha gjermane përdoret nga shumica
- Taksa të ulëta

Kosova ka një numër të sektorëve që ofrojnë mundësi të mira të biznesit siç janë:

Bujqësia - me rreth 60 përqind të popullsisë që jeton në zonat rurale dhe kryesisht punojnë në bujqësi, Kosova ka një traditë të gjatë bujqësore. Në kombinim me klimën e butë që mbizotëron në të gjithë vendin, ekzistojnë kushte shumë të mira për prodhimin bujqësor.

⁶ Banka Qendrore e Kosovës / Raporti vjetor 2016

⁷ Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Minierat dhe Energjia - Kosova ka një pasuri të konsiderueshme të burimeve natyrore. Me 14.7 milion ton, Kosova renditet e pesta në botë me rezerva më të mëdha të linjit. Përveç kapaciteteve gjeneruese të energjisë linjit, Kosova mund të ofrojë mundësi të mëdha në sektorin e energjisë së rinovueshme. Aktualisht rreth 98 përqind e energjisë elektrike prodhohet përmes termocentraleve.

Përpunimi i Drurit - Mbi 40 përqind e tokës së Kosovës është e mbuluar me pyje, ose një sipërfaqe prej rreth 465.000 hektarë. Kosova ka një traditë të gjatë të përpunimit të drurit dhe tokat e saj në përgjithësi janë të pasura me lëndë ushqyese duke siguruar një rritje shumë të mirë për bimët natyrore dhe pemë.

Industria e Përpunimit të Metalit - Kosova ka një histori të gjatë të përpunimit të metaleve dhe ky sektor ka pësuar ndryshime të mëdha gjatë këtyre njëzet viteve të fundit. Ky sektor eksporton një gamë të gjerë të produkteve të metalit, Kryesisht shirita të gravura të çelikut dhe metal të farkuar, në 15 vende evropiane.

Industria e Gurëve Dekorativ - Disponueshmëria e një prej gurëve dekorativ më të bukur në botë është një nga sekretet më të fshehura të Kosovës. Gjeologjia e Kosovës është e pasur dhe e llojllojshme dhe evoluimi i saj me kalimin e kohës ka qenë i ndikuar nga vendndodhja e saj në një zonë tektonike.

Turizmi - Vlerat natyrore të Kosovës paraqesin resurse turistike të cilësisë së lartë. Përshkrimi i potencialit të Kosovës në fushën e turizmit është i lidhur ngushtë me pozitën gjeografike të Kosovës. Malet jugore të Kosovës kanë potencial të madh për turizmin dimëror. Një nga mundësitë më interesante për investitorët e huaj në këtë rajon është resorti turistik i skijimit Brezovica dhe Malet e Sharrit.

Industria e Ndërtimit - Gjatë viteve të fundit industria e ndërtimit u bë një nga sektorët më të rëndësishëm që kontribuojnë në rritjen ekonomike të Kosovës. Industria e ndërtimit mbetet një sektor potencial dhe shumë premtues ekonomik për Kosovën.

Industria e Tekstilit - Me mbi 200 vjet traditë, tekstili ka qenë sektori i dytë më i madh industrial në Kosovë, pas minierave. Në të kaluarën, produktet nga prodhuesit kosovarë kishin shënjestër tregun lokal, si dhe tregje të tjera në të gjithë ish-Jugosllavinë, Evropën Perëndimore, Lindore si dhe Shtetet e Bashkuara.

Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit - Sipas të dhënave të fundit të Autoritetit Rregullator të Telekomunikacionit - ART 15,3 përqind e kosovarëve e përdorin internetin në mënyrë të rregullit. Në krahasim me BE-në ku ka një mesatare prej 38 përqind, për këtë

arsye përdorimi i internetit në Kosovë mund konsiderohet si dukshëm më e ulët se në BE. Ky hendek paraqet një potencial ekzistues të këtij sektori që është duke pritur që të lehtësohet.

Përpunimi i Ushqimit - Klima e Kosovës është e ndikuar nga afërsia e detit Adriatik dhe Egje, si dhe në pjesën veriore konsiderohet tokë kontinentale evropiane. Klima e përgjithshme është një lloj klime kontinentale e modifikuar.

Me rreth 60 përqind e popullsisë që jeton në zonat rurale dhe kryesisht punojnë në bujqësi, Kosova ka një traditë të gjatë bujqësore. Bujqësia është burimi kryesor i të ardhurave për shumicën e popullsisë. Sektori i agrobiznesit dhe Përpunimit të Ushqimit është tradicionalisht një nga sektorët më të fortë në ekonominë e Kosovës.

Incentivat për investime

Stimulimet aktuale mbulojnë çështjet në vijim:⁸

1. Bartja e humbjeve

Bazuar në Ligjin 05/L-029 për Tatimin e të Ardhurave në Korporata, neni 23 i Ligjit përcakton bartjen e humbjes deri në gjashtë (6) vite, gjithashtu edhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ 02/2016.⁹

2. Zbritjet e veçanta për asetet e reja

Për "Zbritjet e posaçme për pasuritë e reja", neni 17 i Ligji 05/L-029 për Tatimin e të Ardhurave në Korporata dhe neni 19 i Udhëzimit Administrativ 02/2016 ka sqaruar këtë pikë se si duhet trajtuar.

Nëse një tatimpagues blen linjat prodhuese për uzina dhe makineri, inventarë të hekurudhës dhe lokomotiva që shfrytëzohen për transportin hekurudhor, aeroplanë, anije, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda për qëllimet e aktiviteteve ekonomike të tatimpaguesit, lejohet një zbritje e veçantë prej dhjetë përqind (10%) të çmimit të përvetësimit të pasurisë në vitin në të cilin pasuria është vënë për herë të parë në shërbim. Kjo bëhet krahas zbritjes normale të zhvlerësimit të lejueshëm dhe vetëm nëse pasuria është e re ose është vënë për herë të parë në përdorim në Kosovë. Zbritja nuk lejohet nëse pasuria është bartur nga një biznes ekzistues ose një biznes i mëparshëm në Kosovë.

⁸ http://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1_30

⁹ Administrata Tatimore e Kosovës

3. Shmangia nga tatimi i dyfishtë

Shmangia e tatimit të dyfishtë, neni 28 i Ligjit 05/L-029 për Tatimin e të Ardhurave në Korporata, dhe neni 27 i Udhëzimit Administrativ 02/2016 ka sqaruar rregullat ligjore për shmangien e tatimit të dyfishtë.

Tatimpaguesi rezident në Kosovë që përfiton të ardhura nga aktivitetet afariste jashtë Kosovës dhe i cili paguan tatimin në të ardhura në shtete tjera sipas këtij ligji i lejohet një kredi tatimore për tatimin në të ardhura të paguar në shtetin tjetër që i atribuohet të ardhurave që krijohen në shtetin tjetër.

Kreditimi tatimor i lejuar është i kufizuar në shumën e tatimit të jashtëm të paguar në të ardhurat e përfituara jashtë Kosovës, e nuk tejkalon shumën e tatimit obligues në Kosovë në ato të ardhura. Për aq sa tatimi i Kosovës në ato të ardhura tejkalon tatimin e jashtëm të paguar, shuma tepricë duhet të përfshihet në logaritjen e tatimit obligues të Kosovës.

Çdo marrëveshje e zbatueshme ndërkombëtare mbi shmangien e tatimit të dyfishtë do të zëvendësojë dispozitat e këtij neni aq sa ato lidhen me palët e asaj marrëveshje ndërkombëtare.

4. Doganat

Me qëllim të promovimit të prodhimeve vendore, Kodi i ri Doganor dhe i Akcizës i Kosovës, Nr. 03/L- 109 ka aplikuar shkallën zero përqind të tatimit doganor për importin dhe eksportin e disa mallrave të caktuara kapitale, materialeve të papërpunuara, lënda e parë e prodhimeve bujqësore dhe shërbimeve.

Për më shumë informata vizitoni: www.dogana-ks.org/tarik/.

5. Garantimi i investimeve

Agjencia multilaterale për garantim të investimeve (MIGA) (anëtare e Grupit të Bankës Botërore) garanton investime në Kosovë deri në shumën 20 milionë Euro.

Korporata për Investime Private të Jashtme nga SHBA-të (OPIC) po ashtu ofron siguri nga rreziku politik për investuesit e huaj në Kosovë.

Për investimet dhe garancitë kreditore nga Austria, duhet të kontaktohet Austrian Kontrollbank (OeKB) dhe për Gjermani, Euler Hermes Kreditversicherung.

6. Toka

Sipas Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Nr. 03/L-040), komunat e Kosovës kanë të drejtë që të japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme investitorëve të huaj. Dhënia me qira mund të bëhet për kohë prej dhjet vitesh me mundësi vazhdimi për deri 99 vjet.

Korniza ligjore aktuale në Kosovë lejon incentivat për investitorët të huaj dhe vendor. Qëllimi i tyre është për të promovuar rritjen e sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM). Incentivat aktuale mbulojnë çështjet si më poshtë:

- Marrja përsipër e humbjeve;
- Shtesat e veçanta të aseteve të reja;
- Shmangia nga tatimi i dyfishtë;
- Dogana;
- Garantimi i investimeve;

Sipas Ligjit për Investimet e Huaja të Kosovës, investitorët e huaj kanë të drejta dhe obligime të barabarta sikurse banorët e Kosovës dhe trajtohen barabartë.

Në mënyrë që Kosova të bëhet një destinacion edhe më atraktiv për investitorët e huaj, Ministria e Financave ka përfunduar një draft të Udhëzimit Administrativ (UA) për Pushimet Tatimore, i cili do të jetë pjesë e pakos fiskale nr.2 që pritet të hyjë në fuqi gjatë vitit 2017.

UA për Pushimet Tatimore është bërë me qëllim që bizneset të cilat krijojnë investime dhe gjenerojnë vende të reja të punës, lirohen nga tatimet për një periudhë të caktuar.

Janë paraparë 4 kategori si në vijim¹⁰:

- ✓ Bizneset që investojnë mbi 10 milionë Euro dhe punësojnë së paku 120 punëtorë brenda 3 viteve, përfitojnë lirimin prej tatimit për 6 vitet e para.
- ✓ Bizneset që investojnë mbi 5 milionë Euro dhe punësojnë së paku 80 punëtorë brenda 3 viteve, përfitojnë lirimin prej tatimit për 4 vitet e para.
- ✓ Bizneset që investojnë mbi 2 milionë Euro dhe punësojnë së paku 50 punëtorë brenda 2 viteve, përfitojnë lirimin për 3 vitet e para.
- ✓ Bizneset që investojnë mbi 500 000 Euro dhe punësojnë së paku 30 punëtorë brenda 1 viti, përfitojnë lirimin për 2 vitet e para.

¹⁰ Ministria e Financave. Meqë nëse, UA për Pushimet Tatimore ende nuk është finalizuar por aktualisht është vetëm draft, ka mundësi që drafti të pësojë ndryshime.

7. Përmirësimi i qasjes në financa dhe certifikimi i produkteve

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore është funksionalizuar dhe deri tani ka lëshuar rreth 63 kredi për bizneset vendore. Nga projekti për certifikimin e produkteve kosovare me standarde të cilësisë të njohura ndërkombëtarisht, i cili po implementohet nga BERZH në bashkëpunim me USAID dhe donatorët tjerë, kanë përfituar rreth 20 ndërmarrje kosovare.

Procedurat e regjistrimit të biznesit

Shoqëritë tregtare siç përcaktohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare kërkohet të regjistrohen në zyrën qendrore të ARBK-së në Prishtinë ose në njërin nga 28 qendrat komunale për regjistrimin e bizneseve gjithandej nëpër Kosovë. Bizneset regjistrohen pa pagesë dhe brenda afatit të shkurtë kohor: një ditë për biznese individuale dhe tre ditë për biznese të shoqërive aksionare. Kjo është mundur me integrimin e sistemit me ç'rast bizneset marrin një certifikatë me dy numra: numrin e biznesit dhe numrin fiskal. Gjithashtu, është larguar kapitali fillestar dhe janë thjeshtësuar procedurat e regjistrimit.¹¹

Më poshtë janë të paraqitura numri i shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe vitit të regjistrimit.¹²

Tabela 4: Numri i shoqërive tregtare të regjistruara sipas formës ligjore dhe vitit të regjistrimit

Viti	Biznesi individual	Ortakëri e përgjithshme	Ortakëri e kufizuar	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	Shoqëri aksionare	Degë e kompanisë së huaj	Kooperative bujqësore	Totali
2014	7,355	91	1	2,125	29	66	4	9,671
2015	7,385	78	-	2,257	27	50	8	10,075
2016 (Janar-Qershor)	1,847	14	-	1,032	6	10	1	2,910

Burimi: ARBK

Në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, kompania e huaj përkufizohet si një shoqëri tregtare që është themeluar dhe aktualisht ekziston sipas një ligji të një juridiksioni jashtë Kosovës dhe e cila mund të angazhohet në aktivitete afariste në Kosovë përmes regjistrimit të një dege në Kosovë në ARBK.

¹¹ www.arbk.rks-gov.net

¹² USAID&ARBK "Indikatorët bazë të performances për regjistrimin e bizneseve në Kosovë", Tetor 2016

Tabela 5 më poshtë tregon numrin total të degëve të kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, sipas vendit të origjinës nga viti 1999 deri më 30 qershor 2016.

Tabela 5: Degët e kompanive të huaja të regjistruara në Kosovë

Nr.	Shteti	Degët e kompanive të huaja
1.	Shqipëria	168
2.	Maqedonia	58
3.	Gjermania	58
4.	Zvicra	51
5.	Turqia	50
6.	Shtetet e Bashkuara	38
7.	Slovenia	38

Burimi: ARBK

Për regjistrim fillestar një aplikim mund të bëhet në çdo qendër komunale të ARBK-së, varësisht nga selia apo vendi i ushtrimit të veprimtarisë së subjektit që kërkon regjistrimin.

Për të filluar një regjistrim, një aplikanti i duhet të plotësojë formularin e aplikimit. Përpara se të plotësohet formulari i aplikimit, aplikanti duhet të dijë informacionin e mëposhtëm: Formulari i aplikimit është specifik për lloje të ndryshme shoqërisht tregtare që aplikojnë (persona fizikë që bëjnë biznes apo korporatë). Prandaj, aplikanti duhet të sigurohet që ai/ajo e di, nëse aplikimi do të jetë për një person fizik, i cili do regjistrohet për të kryer biznes apo për një korporatë si dhe llojin e korporatës. Informacioni mbi kërkesat ligjore të shoqërive tregtare mund të gjendet në ligjin Nr.02//L-123 për Shoqëritë Tregtare. Ky ligj mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e internetit të ARBK-së.

Për më shumë informata linku në vijim: <https://arbk.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,33>

Tatimet dhe tarifat doganore

Politika tatimore në Kosovë është e orientuar drejt rregulloreve të thjeshta të cilat sigurojnë bazë të gjerë tatimore dhe parandalojnë evazionin tatimor. Tatimet dallojnë në bazë të formës së biznesit dhe qarkullimit vjetor. Pakoja fiskale nr.1 ka hy në fuqi në muajin Shtator 2015 dhe si rezultat i kësaj pakoje kanë pësuar ndryshime ligji për TVSH, ligji për Tatimin në të Ardhura Personale (TAP), Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (TAK), është hartuar Udhëzimi Administrativ për zbatimin e TVSH-së dhe Ligji për Faljen e Borxheve Publike.

Në pakon e parë fiskale është hequr TVSH për makineri prodhuese, për lëndën e parë dhe për teknologji informative. Po ashtu, me këtë pako kanë ndryshuar të ardhurat për korporata për lirimet tatimore dhe lehtësira të tjera fiskale për bizneset sa i për ketë investimeve të reja.

Ndërsa, në pakon e dytë fiskale e cila pritet të hyjë në fuqi gjatë vitit 2017, sipas analizave dhe vlerësimeve nga ana e Ministrisë së Financave, kjo pako do të përmbajë shtatë elemente/masa bazë:

1. Zgjerimi i listës së produkteve që konsiderohen si lëndë e parë, për lirim nga tatimi doganor;
2. Heqja e normës së akcizës në mazut;
3. Ndryshim/plotësimi i listës së produkteve që i nënshtrohen normës 0 përqind apo normës së reduktuar 8 përqind të TVSH-së;
4. Udhëzimi Administrativ për Pushimet Tatimore;
5. Nxjerrja e akteve të nevojshme legjislativë për kushtet e veçanta të evidentimit, kontrollit dhe shënjimit të miellit i cili vendoset në qarkullim të lirë në tregun e Republikës së Kosovës;
6. Nxjerrja e akteve të nevojshme legjislativë për kushtet e caktuara nën të cilat pranohen (njihen) humbjet nga prishja, avullimi apo humbja e peshës së naftës dhe produkteve të saj;
7. Krijimi i kodeve të reja doganore për disa produkte, sipas praktikave të BE-së.

Administrata Tatimore e Kosovës aplikon llojet e tatimeve si në vijim¹²:

- o Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH)
- o Tatimi mbi të ardhurat e korporatave (TAK)
- o Tatimi mbi të ardhurat personale (TAP)

Tatimi në korporata është 10 përqind në fitimin e biznesit, ndërsa pagesa për tatimin në të ardhura në korporatë është 3 muajore me këste/paradhënie dhe tatimi është vjetor.

TVSH është aktualisht me tri norma: 0 përqind - për eksportet, 8 përqind - për produktet esenciale dhe 18 përqind - për produktet e luksit. Pagesa është mujore për TVSH.

Tatimi në të ardhura personale është sipas shkallëve.

¹² <http://www.atik-ks.org/7422-2/#>

- Deri 250 € është 4%
- Deri 450 € është 8%
- Mbi 450 € është 10%

Tabela 6: Sistemi i tatimeve në rajon (TVSH&TAK) – 2015

	Tatimi mbi vlerën e shituar	Tatimi mbi të ardhurat e korporatave
Shqipëria	20%	15%
Bosnja dhe Hercegovina	17%	10%
Kroacia	25%	20%
Maqedonia	18%	10%
Mali i Zi	19%	9%
Serbia	20%	15%

Burimi: World Bank Doing Business Report 2016

TVSH nuk duhet të të paguhet për transaksionet në vijim duke mos u kufizuar në to:

- importimin e sendeve personale të udhëtarit të lejuara sipas dispozitave doganore në fuqi;
- importin e mallrave turistike të lejuara nga dogana sipas dispozitave në fuqi të Doganës;
- importet ose furnizimet e financuara nga donacionet e bëra përmes Ministrive dhe Departamentet qeveritare, organizatat qeveritare, organizatat joqeveritare me status të beneficuar publik si ndihmat për programet humanitare dhe rindërtimin e Kosovës;
- importet ose hyrjet të cilat i kanë bërë përfaqësuesit diplomatikë ose janë bërë për ta apo për zyret e ndërlidhjes;
- importet apo hyrjet brenda të cilat i kanë bërë Kombet e Bashkuara ose janë bërë për to apo për cilindo nga organet e saj, duke përfshirë UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-in, Bankën Botërore dhe organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare ;
- importet apo hyrja e barnave brenda, shërbimet spitalore dhe kujdesi mjekësor, produktet farmaceutike, instrumentet mjekësore apo kirurgjike
- gjobitja me para ose dënimi i bërë nga autoritetet publike;

- furnizimi i barnave, i shërbimet mjekësore, i produkteve farmaceutike, i instrumenteve mjekësore apo pajisjeve kirurgjike;
- furnizimet e shërbimeve të arsimit publik dhe privat;
- furnizimet e shërbimeve financiare;
- transferimi i titullit të pronësisë, qiraja e tokës dhe e shtëpive të banimit;
- sigurimi i lejeve ose licencave bashkë me pagesën nga organet komunale ose publike.

Mbledhja e taksave doganore si Taksat doganore, Tatimi mbi vlerën e shtuar, Akcizën, derdhen në Buxhetin e Kosovës duke ndihmuar kështu zhvillimin ekonomik të shtetit. Gjithashtu, Dogana e Kosovës kontrollon importimin dhe eksportimin duke mundësuar mbrojtjen e ekonomisë si dhe mbrojtjen e markave tregtare, dhe gjeneron statistika të sakta për tregtinë e jashtme.

Dogana e Kosovës është e gatshme që të përkrahë të gjithë investitorët potencial. Kjo përkrahje ju ofrohet atyre që të përfitojnë procedura më të lehta dhe më të shpejta për import.

Tarifat doganore në Kosovë sa i përket importit janë:

- 0% për mallrat që importohen nga vendet e CEFTA
- tarifë progresive për mallrat që importohen nga vendet e BE-së, sipas MSA-së
- 10% për mallrat që importohen nga vendet e treta

Pas ndryshimeve të bëra në sistemin doganor është bërë reduktimi i tarifave doganore për:

- mjetet kapitale (themelore)
- lëndët e para për agrobiznes dhe disa sektorë tjerë të prodhimit
- lëndëve të ndërmjetme për procesim të mëtutjeshëm nga 10% në 0%, si dhe janë hequr detyrimet doganore për:
 - naftën dhe produktet e naftës
 - grurin dhe misrin

Të liruar nga tarifat doganore janë:

- Plehtrat artificiale
- Prodhimet farmaceutike
- Instrumentet dhe aparatura kirurgjike
- Mallrat për qëllime humanitare

- Mallrat që përdoren nga diplomatët e huaj dhe misionet konsulare
- KFOR-i
- UNHCR
- Kryqi i Kuq Ndërkombëtar
- OJQ-të e regjistruara të UNMIK-u që kanë qëllim mbështetjen e programeve dhe projekteve humanitare dhe rindërtuese në Kosovë.

Mbrojtja e investitorëve

Ligji për investimet e huaja nr.04/L-220 ka për qëllim të rregullojë mbrojtjen, promovimin dhe inkurajimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës, t'u ofrojë investitorëve të huaj të drejta dhe garanci themelore, që u japin siguri investitorëve të huaj që investimet e tyre të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë të drejtë në pajtim me standardet dhe praktikatat e pranura ndërkombëtare.¹⁴

Në bazë të këtij ligji një investues i huaj, i definuar si person fizik që nuk është banor i përhershëm i Kosovës, një biznes apo organizatë tjetër, entitet apo asociacion i themeluar jashtë juridiksionit të Kosovës, duhet të udhëhiqet nga parimi i trajtimit nacional, që do të thotë se ndërmarrjet e huaja do të trajtohen nësoj si ndërmarrjet e ngjashme vendore.¹⁵

Në veçanti, të drejtat që i takojnë një investitori të huaj janë:

- Trajtimi jo-diskriminues
- Mbrojtja dhe siguria e vazhdueshme
- Kompensimi në rast të nacionalizimit apo shpronësimit, duke përfshirë edhe pagesën e interesit
- Kompensimi në rast të shkeljeve të ligjeve të aplikueshme dhe ligjit ndërkombëtar për Kosovën
- Transferimi i lirë si dhe përdorimi i pakufizuar i të ardhurave
- Mbrojtja ndaj aplikimit retroaktiv të ligjeve

Vlen të theksohet se MSA parashikon mbrojtjen e investitorëve ku sipas nenit 98 të MSA-së, parashihet krijimi i një bashkëpunim në mes të palëve për të mbrojtur investimet e huaja direkte duke sjellur një klimë më të mirë për investitorët e brendshëm, si dhe të jashtëm, gjë esenciale për revitalizimin ekonomik dhe industrial të Kosovës.

¹⁴ <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-220%20sh.pdf>

¹⁵ <http://www.invest-ks.org/sq/Legjislatiioni-dhe-Marreveshjet>

Po ashtu janë paraparë dispozitat ligjore për themelimin e divizionit për kontestet lidhur me investitorët e huaj, me juridiksion për tërë territorin e Kosovës në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Në muajin Tetor 2016 nga Kuvendi i Kosovës është aprovuar Ligji për Investimet Strategjike. Ky ligj konsiderohet se do të lehtësojë procedurat dhe do të rris interesimin e investitorëve të huaj në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij ligji është eliminimi i barrierave, procedurave burokratike - penguese të deritashme - procedurave të stërgjatura e deri te rritja e transparencës për realizimin e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës. Ai i mundëson Qeverisë që të negociojë drejtpërdrejtë me investitorët e huaj, por edhe ata vendorë. Njëkohësisht, ofron kushte të barabarta në aspektin e tërheqjes së investitorëve të huaj, në krahasim më vendet fqinje dhe vendet e rajonit.

Marrëveshjet

Qeveria e Kosovës ka nënshkruar disa marrëveshje bilaterale lidhur me promovimin investimeve dhe mbrojtjen e tyre, me: SHBA (OPIC), Gjermaninë, Austrinë, Turqinë, Shqipërinë, Belgjikën dhe Luksemburgun, Zvicrën, Maqedoninë, Kroacinë, Malin e Zi, Kuvajtin dhe Katarin. Në proces është edhe marrëveshja me Kanadën.

Mjedisi afarist

Në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) gjatë vitit 2016 ka bërë unifikimin e numrit të regjistrimit të biznesit me numrin për eksport dhe import dhe po punohet me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) që bizneset ta kenë vetëm një numër. Është shkurtuar afati kohor për regjistrimin e bizneseve dhe janë implementuar rekomandimet e task forces "Doing Business" të udhëhequr nga MTI. Prej 3.5 ditëve sa është dashur më herët për regjistrimin e biznesit është shkurtuar afati kohor në 1.9 ditë. Në raportin e Bankës Botërore në të bërit biznes Kosova është renditur në vendin e 13-të për regjistrim të biznesit. Janë bërë eliminime dhe reduktime të tarifave për shërbimet e ofruara për bizneset në procesin regjistrimit të tyre. Është zhvilluar moduli për regjistrimin online të bizneseve. Është avancuar regjistri i pengut dhe ofron shërbime shumë të avancuara sipas kërkesave të bankave. Janë regjistruar 10,504 biznese ndërsa janë shuar 2,290 biznese. Numri i bizneseve me pronarë të huaj është 655 ndërsa shoqëri me përgjegjësi të kufizuar 3,979.

Më poshtë paraqiten indikatorët e raportit të të bërit biznes për vitin 2017 dhe krahasimi i vitit 2017 me atë të vitit 2016.¹⁶

Tabela 7: Rangimi i Kosovës në Doing Business 2017 (Pozita 1-190)

	2017
Pozita	60
Fillimi i biznesit	13
Lejet e ndërtimit	129
Energjia elektrike	114
Regjistrimi i pronës	33
Marrja e kredisë	20
Mbrojtja e investitorëve	63
Pagimi i taksave	43
Tregtia përtej kufijve	51
Zbatimi i kontratave	44
Zgjidhja e insolvencës	163

Tabela 8: Krahasimi i indikatorëve 2016-2017 (Pozita 1-190)

	2017	2016	Ndryshimi në rangim
Pozita	60	64	14
Fillimi i biznesit	13	27	14
Lejet e ndërtimit	129	125	4
Energjia elektrike	114	111	3
Regjistrimi i pronës	33	33	-
Marrja e kredisë	20	19	1
Mbrojtja e investitorëve	63	62	1
Pagimi i taksave	43	77	34
Tregtia përtej kufijve	51	59	8
Zbatimi i kontratave	44	43	1
Zgjidhja e insolvencës	163	164	1

Burimi: Raporti i Bankës Botërore për të bërit biznes, 2017

¹⁶ <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/kosovo>

Ekonomitë renditen në lehtësinë e tyre për të bërë biznes, nga 1-190. Një renditje e lartë në lehtësinë e të bërit biznes do të thotë mjedisi rregullator është më i favorshëm për fillimin dhe funksionimin e një firme vendore.

Regjimi tregtar

Kosova ka një regjim liberal tregtar dhe ka tre përfitime të mëdha nga liberalizimi i tregtisë: mundësi me të mira për eksport, një mjedis më të mirë të investimeve, dhe marrëdhënie të qëndrueshme me fqinjët e saj.

Kosova aktualisht gëzon tregti të lirë në kuadër të Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë-CEFTA, duke u mundësuar prodhuesve të saj t'i qasen tregut rajonal prej 25 milionë konsumatorëve, pa asnjë obligim doganor.¹⁷

Me 1 Prill 2016 ka hyrë në fuqi Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit me BE-në, ku Kosova dhe BE kanë negociuar një marrëveshje asimetrike që do të thotë që në momentin e hyrjes në fuqi të gjitha prodhimet nga Kosova (me përjashtim të atyre për të cilat janë negociuar kuota) do të kenë qasje të pakufizuar në tregun e BE, ndërsa qasja e prodhimeve të BE-së do të liberalizohet në përputhje me afatet kohore ku disa prodhime do të fitojnë qasje të menjëhershme, ndërsa pjesa më e madhe do të liberalizohet në afat prej tri, pesë dhe shtatë vitesh. Për më tepër një kategori e prodhimeve, për të cilat Kosova ka konsideruar që ka potencial vendor e ku hyjnë kryesisht prodhimet bujqësore, do të qëndrojnë jashtë skedulit të liberalizimit deri në dhjetë vjet. Tek pjesa e produkteve me kuota, përfitimin më të madh do ta kenë prodhuesit vendor të verës, për të cilët në momentin kur hyn në fuqi MSA, kuota e eksportit pa tarifa doganore do të rritet për dy herë e gjysmë.¹⁸

Në anën tjetër, Kosova përfiton nga Sistemi i Përgjithshëm i Preferencave me SHBA-në, Japoninë, Norvegjinë dhe Zvicrën. Ky sistem eliminon tarifat doganore për një numër të caktuar të produkteve (rreth 5 000 produkte).

Po ashtu, është negociuar Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Turqinë dhe është në pritje të nënshkrimit nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

¹⁷ <http://www.invest-ks.org/sq/Sistemi-Liberal--Tregtar>

¹⁸ <https://sbunker.net/beh/45943/cka-do-te-thote-msa-ja-per-ekonomine-e-kosoves/>

Importet dhe eksportet 2010-2016

Shkëmbimet tregtare të Kosovës, gjatë vitit 2016, arritën vlerën mbi 3 miliard Euro, tregues i cili shënoj rritje për 4.7 përqind në raport me vitin 2015, trend që reflekton një tendencë të rritjes së importeve dhe rënie të eksporteve.

Importet e mallrave në Kosovë arritën vlerën prej 2,789,700,000 Euro duke ndjekur një ecuri vjetore më të lartë me atë të vitit 2015 (me një rritje vjetore prej 5.9 përqind).

Lëvizja e çmimeve për disa mallra në tregjet ndërkombëtare kishte si pasojë ecurinë e vlerës së eksporteve kosovare me ndikim edhe në tregtinë e jashtme të Kosovës. Çmimet të cilat më së shumti shënuan rënie janë çmimet e metaleve bazë të cilat kanë pjesëmarrje të konsiderueshme në tregtinë e Kosovës.

Eksportet e Kosovës shënuan vlerën prej 309.6 milionë Euro, apo 4.8% rënie, krahasuar me vitin 2015, rënie e cila ka rritur edhe më tutje bilancin negativ tregtar të Kosovës. Nga krahasimi i mallrave të eksportuara në vitin 2016 në raport me vitin 2014 situata është e ngjashme me atë të vitit paraprak, andaj në vitin 2016 kemi një rënie të eksporteve për 4.6 përqind në raport me vitin 2014.

Kosova në masë të madhe është e varur nga importet, si rrjedhojë, mbulimi i importeve nga eksportet u zvogëluar në 11 përqind krahasuar me 12.3 përqind që ky tregues ishte në vitin 2015.

Tregtia me vendet e BE-së dhe vendeve të rajonit pjesëmarrës në CEFTA, përbën pjesën më të rëndësishme të shkëmbimeve tregtare të Kosovës, me rreth 71% të gjithë tregtisë së jashtme.

Tabela 9: Tregtia sipas grup vendeve, në %

Grup Vendet	Exp/Imp	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
BE	Eksporti	44.5	43	38.4	39.4	30.2	32.6	22.6
	Importi	38.3	38	38.7	41.3	42.6	42.2	43.1
CEFTA	Eksporti	23.5	26	36.8	36.4	39.2	38	46.6
	Importi	37	35	33.7	30.6	28.4	29.2	27.0
Të tjera	Eksporti	32	31	24.8	24.1	30.6	29.4	30.8
	Importi	24.5	27	27.6	28.1	29	28.6	29.9


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tabela 10: Eksportet e Kosovës në pjesën e mbetur të botës – partnerët kryesor (në '000 euro)

Viti/Vendi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Turqia	Eksporti 9,357	7,831	11,380	7,393	10,365	9,212	7,630
	Importi 150,360	184,452	199,881	204,922	238,268	252,285	288,488
Zvicra	Eksporti 17,786	17,611	15,132	7,155	10,038	11,721	16,762
	Importi 20,981	22,194	22,664	21,020	30,185	23,674	21,796
Kina	Eksporti 14,779	28,268	3,266	1,290	42,152	206	11,694
	Importi 135,406	170,285	159,651	179,554	204,789	232,925	258,473
India	Eksporti 44,895	15,482	22,889	28,953	27,425	47,029	9,425
	Importi 6,182	8,304	9,709	14,429	9,462	13,602	18,960


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Grafikoni 2: Eksportet e Kosovës 2010-2016 ('000 €)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Grafikoni 3: Importet e Kosovës 2010-2016 ('000 €)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Tregtia në shërbime

Shërbimet përfaqësojnë sektorin më të shpejtë në rritje të ekonomisë globale dhe përbëjnë 2/3 e prodhimit global, 1/3 e punësimit global dhe përafërsisht 20 përqind të tregtisë globale.¹⁹

Shërbimet përbëjnë një pjesë të madhe të BPV së Kosovës, rreth 65 përqind dhe përfaqësojnë sektorin më të zhvilluar në Kosovë në krahasim me sektorin e mallrave. Sektori i shërbimeve nga viti 2004 performon në mënyrë pozitive.


Sektorët më të zhvilluar ndër vite janë: shërbimet e udhëtimit, shërbimet e ndërtimit, shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit dhe shërbimet e tjera të biznesit.

Tabela 11: Bruto Produkti Vendor me çmime aktuale 2012-2016 (në %)

	2012	2013	2014	2015	2016
Eksporti i shërbimeve	12.6	11.7	13.8	13.7	13.5
Importi i shërbimeve	5.7	5.9	7.7	7.6	7.7

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës


Grafikoni 4: Bilanci tregtar i shërbimeve 2012-2016 (në milion €)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

¹⁹ www.wto.org

Grafikoni 5: Sektorët e shërbimeve me potencial zhvillimi (në milion €)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Legjislati²⁰

Në mënyrë që ekonomia të funksionojë në përputhje me parimet perëndimore të tregut të lirë, në vitin 2016 dhe 2017 në sferën e tregtisë janë aprovuar ligjet si në vijim:

- Ligji për Falimentim
- Ligji për Investime Strategjike
- Ligji për Kamatë-Vonesat Tregtare
- Ligji për Akreditim
- Ligji për Profesionet e Rregulluara
- Plotësim ndryshimi i Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta
- Ligji për Trepçën
- Ligji për Treguesit Gjeografik dhe për Emërtimet e Origjinës
- Ligji për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore
- Ligji për Shërbimet

Ndërsa, Projektligji për Shoqëritë Tregtare, Projektligji për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Projektligji për Produktet e Ndërtimit janë për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës.

²⁰ <http://gazetaraksh.gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=1&InstID=1&CatID=6>

Ligji i punës

Ligji i Punës (Nr. 03/L-212), që ka hyrë në fuqi në 16 dhjetor 2010, është pjesë e legjislacionit bazë të Republikës së Kosovës që rregullon marrëdhënien midis punëmarrësve dhe punëdhënësve. Ky ligj ka për qëllim të mbrojtë të drejtat e të caktojë detyrimet në marrëdhëniet e punës, dhe të sigurojë mbrojtjen në punë. Dispozitat e tij zbatohen si për punësimin në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.²¹

Ligji i Punës duhet të sigurojë përmbushjen e katër parimeve kyçe:²²

- Lirinë e asociimit dhe njohjen e të drejtës për negociata kolektive,
- Zhdukjen e çdo lloji të punës së detyruar dhe të dhunshme,
- Zhdukjen e punës së të miturve,
- Zhdukjen e diskriminimit në punë.

Mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës (Nr. 2008/34). Çdo person fizik apo juridik, që nuk i përfill dispoizitat e këtij ligji, penalizohet me masa ndëshkuese.

Ligji i punës në mes tjerash parasheh:

Elementet e marrëdhënies së punës	Dispozita përkatëse në Ligjin e Republikës së Kosovës
Kontrata	E shkruar
Orët e punës në javë	40 orë
Orari i shkurtuar i punës	Zbatohet për punët për të cilat punëtori nuk mund të mbrohet nga ndikimet e dëmshme për shëndetin e tij, edhe përkundër aplikimit të masave mbrojtëse
Puna jashtë orarit	Me kërkesën e punëdhënësit në rastet e domosdoshme; më së shumti deri në 8 orë në javë
Pushimi ditor	30 minuta (të përfshira në orarin normal të ditës së punës)
Pushimi javor	Së paku 24 orë
Pushimi vjetor	• Së paku 4 javë në vitin kalendarik (pavarësisht nëse punon me orar të plotë apo të shkurtuar); për çdo 5 vite punë shtohet një ditë pushimi • Përfshirje bëjnë arsimtarët • Festat zyrtare që bien në ditë pune nuk llogariten në ditët e pushimit vjetor

²¹ <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1.191.518>

²² http://www.partneretsocial.org/uploaads/files/2014/June/20/Ligji_i_Punes_ne_Kosove1403267101.pdf

Pushimi vjetor	- Në rast sëmundjeje: 20 ditë pune në vit me kompensim të plotë të pagës - Në rast të pasigurisë dhe mosmbrojtjes së shëndetit në punë: deri në 45 ditë në vit me kompensim të plotë të pagës - Në rast të pushimit mjekësor prej lëndimit ose sëmundjes të shkaktuar nga kryerja e punëve dhe shërbimeve për punëdhënësin: 10 – 90 ditë në vit me kompensim deri në 70% të pagës 5 ditë në rast të martesës së punëmarrësit 5 ditë në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes 1 ditë për çdo rast të dhënies vullnetare të gjakut
Leja e lehonisë	12 muaj për femrat, duke filluar prej 45 deri 28 ditë para datës së parashikuar të lindjes – kompensimi i rrogës bëhet në masën 70% për 6 muajt e parë, 50% për 3 muajt në vijim dhe 0% në 3 muajt e fundit; - Këto të drejta i realizon babai i fëmijës nëse nëna sëmuret, e braktis fëmijën apo vdes; - Në rastet e tjera, babai ka të drejtë për 2 ditë pushim për lindjen e fëmijës dhe 2 javë pushim të parapaguar derisa fëmija të arrijë moshën 3-vjeçare; - Kushte të tjera zbatohen kur fëmija lind i vdekur ose ka nevojë për përkujdesje të vecantë.
Paga shtesë	Jepet: 20 % në orë për kujdestari 30 % në orë për punë gjatë natës 30 % në orë për punë jashtë orarit 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira e përjashtojnë njëra-tjetrën. I punësuar mund të kërkojë nga punëdhënësi që në vend të pagës shtesë të kompensohet me ditë pushimi.
Puna me orar jo të plotë (min. 20 orë në javë)	Punëmarrësi i kësaj kategorie gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëdhënia e punës sikurse i punësuar me orar të plotë, por në

	proporcion me orët që ka punuar. Ai nuk mund të punojë më gjatë se orari i plotë i punës.
Puna provuese	Lejohet për një kohëzgjatje maksimale prej 6 muajsh.

Paga minimale e caktuar me vendim të Qeverisë së Kosovës në vitin 2011 është 130 Euro për të punësuarit e moshës nën 35 vjeç, dhe 170 euro për të punësuarit e moshës mbi 35 vjeç.

Në Kosovë ekziston Këshilli Ekonomiko-Social (KES) që u bën propozime organeve kompetente për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikën ekonomike në Republikën e Kosovës.

Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore²³

Ky ligj rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen si dhe shuarjen e të drejtave sendore.

Ky ligj rregullon pronësinë si dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit. Këto të drejta sendore të kufizuara mund të krijohen në pronësi apo në të drejta sendore të tjera që mund të jenë të përshtatshme për këtë qëllim.

Ligji për shpronësimin e pronës së paluajtshme²⁴

Me këtë ligj përcaktohen:

- rregullat dhe kushtet sipas të cilave Qeveria ose një Komunë mund të bëjë shpronësimin e të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi;
- rregullat dhe kushtet sipas të cilave Qeveria mund të autorizojë kufizimin dhe shfrytëzimin e përkohshëm të pronës së paluajtshme,
- procedurat për kryerjen e shpronësimit ose kufizimit të pronësisë
- rregullat dhe procedurat të cilat do të përdoren për përcaktimin e shumës dhe pagesës për kompensimin e shpronësimit ose kufizimit të pronësisë; dhe

²³ <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,349>

²⁴ <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,342>

- dispozitat tjera të cilat rregullojnë çështje tjera që kanë të bëjnë me shpronësimin ose kufizimin e pronësisë.

Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës²⁵

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë mënyrën e dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, këmbimin e pronës komunale me persona fizik dhe juridik, si dhe këmbimin e pronës me institucione qendrore dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Qeveria e Kosovës në muajin Janar 2017 ka aprovuar Strategjinë Nacionale për të Drejtat Pronësore. Me anë të kësaj Strategjie synohet që të bëhet lehtësimi i blerjes, regjistrimit, shfrytëzimit dhe shitjes së tokës për popullin e Kosovës.

Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve²⁶

Ky ligj përmban parimet themelore dhe rregullat e përgjithshme për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve.

Neni 12 i këtij ligji rregullon kontratat komerciale ku:

- Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjitha llojeve të kontratave, përveç nëse me ligj përcaktohet ndryshe.
- Kontratat komerciale janë kontrata të lidhura nga subjektet komerciale ndërmjet tyre.
- Entitetet afariste të përcaktuara me ligj, si dhe personat e tjerë juridik që kryejnë veprimtari fitimprurëse konsiderohen subjekte afariste në kuptimin e këtij ligji.
- Personat e tjerë juridik konsiderohen subjekte komerciale në kuptimin e këtij ligji kur në pajtim me dispozitat ligjore, herë pas here ose gjatë veprimtarive të tyre parësore, përfshihen në veprimtari fitimprurëse, në rast se çështja ka të bëjë me një kontratë në lidhje me këto veprimtari fitimprurëse.

Kreu i parë i këtij ligji rregullon lidhjen e kontratës, mosmarrëveshjet, lidhjen e detyrueshme dhe përmbajtja e detyrueshme e kontratës.

²⁵ <https://mafi.rks-gov.net/getattachment/3398d99f-918f-4096-886a-ba9d28820ee2/Projektligji-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-Ligjit-azox>

²⁶ <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20marrredheniet%20e%20detyrimeve.pdf>

Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale

Kosova në fushën e pronësisë industriale dhe intelektuale ka dy institucione përgjegjëse: Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrinë e Kulturës.

Agjencia e Pronësisë Industriale (API) vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe është institucioni i vetëm në Kosovë përgjegjës për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale në Kosovë.²⁷ Agjencia e Pronësisë Industriale është e përkushtuar që të promovojë të drejtat pronësore industriale në Kosovë në mënyrë që komuniteti i biznesit të kuptoj rëndësinë e patentës, markës tregtare, dizajnit industrial, emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik.

Agjencia e Pronësisë Industriale në kuadër të detyrave të saj:

- Shqyrton kërkesat për mbrojtjen e të drejtave të objekteve të pronësisë industriale; Mirëmban të dhënat për të drejtat e fituara për mbrojtje të objekteve të pronësisë industriale;
 - Propozon, harton dhe publikon buletin zyrtar të Agjencisë të Pronësisë Industriale;
 - Promovon mbrojtjen e pronësisë industriale;
 - Propozon ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e pronësisë industriale
 - dhe siguron përbushjen e obligimeve që dalin nga to;
- Bën shërbime të tjera informative, posaçërisht bën kërkime në bazat e të dhënave.

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta²⁸ është organ administrativ i cili është themeluar dhe funksionon në kuadër të Ministrisë për Kulturë. Në obligimet e Zyrës hynë:

- Dhënie e lejes shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave;
- Marrjen e lejes së dhënë Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave në rast të mospërbushjes së kriterëve të parapara me ligj;
- Mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave;
- Promovimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për dhënie e informatave të duhura autorëve, bartësve të të drejtave dhe opinionit të gjerë lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;

²⁷ <http://kipsa.rks-gov.net/>

²⁸ <http://www.mkra-lks.org/?page=1,157>

- Përcjelljen e legjisllacionit ndërkombëtar dhe dhënien e rekomandimeve përkitazi me fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqëta.

Fusha e pronësisë industriale dhe intelektuale rregullohet përmes ligjeve si në vijim:

- Ligji Nr.04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqëta
- Ligji Nr. 05/L-058 për dizajnin industrial
- Ligji Nr. 05/L-051 për treguesit gjeografik dhe për emërtimet e origjinës
- Ligji Nr. 04/L-026 për markat tregtare
- Ligji Nr. 04/L-029 për Patenta

Transporti rrugor

Territori i Kosovës ka infrastrukturë të përshtatshme rrugore për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme afariste. Rrjeti rrugor përbëhet nga 730 km rrugë kryesore. Me ndërtimin e autostradës me Shqipërinë, Kosova është një urë e rëndësishme në mes Evropës Perëndimore dhe Detit Adriatik.

Transporti hekurudhor

Kosova ka sistem hekurudhor prej 330 km duke mbuluar gjithë territorin e Kosovës, duke lidhur veriun me jugun dhe lindjen me perëndimin.

Transporti ajror

Kosova ka një aeroport, Aeroportin e Prishtinës, i cili është një nga aeroportet më të frekuentura në rajon. Ky aeroport ofron fluturime në shumicën e qendrave në Evropë por gjithashtu edhe në SHBA.

Diaspora e Kosovës

Roli i diasporës kosovare është i rregulluar me Ligjin Nr.04/L-095 për diasporën dhe mërgatën. Diaspora kosovare ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës gjatë viteve '90-ta dhe pas vitit 1999. Për shkak të këtij roli të pamohueshëm në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të Kosovës është themeluar Ministria e Diasporës, si nevojë e posedimit të një adrese për diasporën kosovare.

Sa i përket dërgesave (remitencave) nga diaspora kosovare, ndër vite kemi një kontribut të jazhtëzakonshëm gjë që ka ndikuar edhe në uljen e varfërisë në Kosovë.


Ministria e Diasporës është në procesin e regjistrimit të diasporës dhe deri më tani janë regjistruar 400 mijë kosovarë që jetojnë në diasporë dhe procesi i regjistrimit ende vazhdon.

Remitencat e pranua në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, shënuan vlerën prej 691.0 milionë Euro, që paraqet një rritje vjetore prej 3.8 përqind. Remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 37.1 përqind përkatësisht 22.6 përqind të gjithsej remitencave të pranua në Kosovë. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.8 përqind e gjithsej remitencave të pranua në Kosovë.

Projeksionet makroekonomike për vitin 2017 sugjerojnë se ekonomia e Kosovës do të karakterizohet me rritje reale prej 3.7 përqind. Kjo rritje pritet të gjenerohet nga kërkesa e brendshme, ndërsa neto eksportet parashihet të kenë ndikim më të vogël negativ në BPV. Konsumi, si komponenta kryesore e kërkesës së brendshme, pritet të shënojë rritje reale prej 2.1 përqind, bazuar në pritjet që konsumi privat do të rritet me 2.4 përqind dhe konsumi publik me 0.6 përqind. Faktorët që pritet të ndikojnë në rritjen e konsumit privat, ndër të tjera, janë edhe rritja e remitencave dhe rritja e kredive. Deri në fund të vitit 2017, remitencat pritet të shënojë rritje vjetore prej rreth 2.8 përqind.

Më poshtë janë të paraqitura të dhënat²⁹:

Grafikoni 6: Dërgesat e emigrantëve (miliona €)



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Tabela 12: Dërgesat e emigrantëve, sipas shteteve (miliona €)

Përshkrimi	Gjermania	Zvicra	Italia	Austria	Belgjika	SHBA	Suedia	Norvegjia
2013	135.8	95	30.6	23.9	9.3	17.4	11.5	10.2
2014	145.6	90	19.8	15	10.5	24.9	11.6	12.8
2015	146.9	89.5	19.3	14	9.9	32.1	11.5	11
2016	148.5	90.6	21	14.4	9.2	27.5	13.5	8.1

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Sektori bankar në Kosovë

Në Kosovë sot operojnë 10 (dhjetë) banka komerciale dhe përbëjnë 69.0 përqind të aseteve totale të sektorit financiar³⁰. Produktet dhe shërbimet e tyre përfshijnë llogaritë bankare, kreditë, pagesa vendore dhe ndërkombëtare, kartela bankare, garancione bankare, letër kredi, e-banking. Qasja në shërbimet e këtyre bankave mundësohet përmes aktualisht 263 degëve dhe nëndegëve, 540 ATM-ve dhe 9,493 POS dhe 196,656 llogarive e-banking.

²⁹ <http://www.bok-kos.org/?id=55>

³⁰ <http://bankassoc-kos.com/sektori-bankar>

Aktiviteti i tyre dominohet nga kreditë, afati i maturimit të të cilave mund të jetë deri në 15 vjet, varësisht nga lloji i kredisë. Nga totali i kredive, 65.2 përqind janë kredi për ndërmarrjet. Pjesa më e madhe e këtyre kredive absorbohet nga ndërmarrjet e sektorit të tregtisë (51.8 përqind e kredive të ndërmarrjeve), përderisa sektori i industrisë (përfshirë minierat, prodhimtarinë, energjinë dhe ndërtimtarinë) ka 23.0 përqind të gjithsej kredive të ndërmarrjeve. Sektori i bujqësisë aktualisht përbën 4.0 përqind të gjithsej kredive për ndërmarrje. Pjesëmarrja e kredive për ekonominë familjare është 34.4 përqind të gjithsej kredive.

Struktura e detyrimeve të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përfaqësojnë 80.2 përqind të gjithsej detyrimeve. Depozitat e sektorit bankar kanë shënuar rritje vjetore prej 6.5 përqind, duke arritur vlerën prej 2.7 miliardë Euro. Depozitat e sektorit bankar në Kosovë përbëhen nga depozitat e ekonomive familjare me një pjesëmarrje prej rreth 74.4 përqind të depozitave të gjithëmbarshme, përderisa depozitat e ndërmarrjeve private përbëjnë 20.1 përqind.

Bankat komerciale në Kosovë kanë strukturë të ndryshme aksionare. Tetë prej tyre janë banka me kapital të huaj dhe dy me kapital vendor.

Numri i të punësuarve në bankat komerciale është rreth 3,337.

Aktiviteti i bankave rregullohet përmes dy ligjeve: Ligji për Bankën Qendrore të Kosovës dhe Ligji për Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare jo bankare.


Ligjet tjera përkatëse mund të gjinden në këtë link: <http://bankassoc-kos.com/sektori-bankar/ligjet-perkatese>.

Fuqia punëtore dhe tregu i punës në Kosovë

Kosova është e bekuar me një fuqi punëtore të re, të aftësuar, që flet shumë gjuhë, të motivuar, dhe me një shpirt të lartë sipërmarrësie. Duke e marrë parasysh fuqinë punëtore në dispozicion dhe ligjin liberal të punës që rregullon tregun vendor të punës, punësimi i punëtorëve në Kosovë është efikas dhe i thjeshtë.³¹

³¹ http://kiesia.rks-gov.net/page.aspx?id=1_28

Grafikoni 7: Punëkërkuet të regjistruar sipas kualifikimeve gjatë vitit 2015



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Në Kosovë veprojnë tetë Institucione Publike të Arsimit të Lartë me lokacion në Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Gjakovë dhe Mitrovicë.

Ndërsa, janë po ashtu afër 30 Institucione Private të Arsimit të Lartë. Shumë nga këto institucione bashkëpunojnë me universitete tjera në botë si me: The Rochester Institute of Technology, University of Sheffield dhe Staffordshire University.³²

Tabela 13: Numri i studentëve në Universitetin e Prishtinës sipas viteve

Viti	Nr. i studentëve
2011/2012	47 070
2012/2013	47 640
2013/2014	45 879
2014/2015	44 606
2015/2016	40 383

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

³² http://kiesia.rks-gov.net/page.aspx?id=1_29

Në vitin 2016 shkalla e punësimit nëpër grupmosha ishte më e larta në mesin e personave të moshës mes 35-44 vjeç (40,5 përqind) dhe më e ulta në mesin e të rinjve (15-24 vjeç) (11,2 përqind)³³.

Tabela 14: Numri i të punësuarve dhe shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës

Punësimi % Moshë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
15-24	16,8	5,1	11,2
25-34	52,6	16,5	36,1
35-44	64,7	17,9	40,5
45-54	63,7	17,9	39,1
55-64	52,1	9,9	31,2
Totali 15-64	45,6	12,9	29,5

Burimi: Publikimi nga ASK "Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore TM4-2016"

Gjatë analizimit të nivelit më të lartë arsimor, të arritur nga të punësuarit, vërehet që pothuaj 60 përqind e tyre kanë të përfunduar shkollën e mesme profesionale, kurse mbi një e katërta (27.5 përqind) kanë të përfunduar arsimin terciar (tabela 15).

Tabela 15: Punësimi sipas nivelit arsimor

Niveli arsimor %	Joaktiv	I/e punësuar	I/e papunë	Të gjithë
Pa shkollë	3.5	0.1	0.7	2.3
Klasët I-IX	49.8	15.0	26.7	38.1
Arsim i mesëm profesional	20.3	36.2	41.3	26.9
Shkollë e mesme gjimnaz	19.9	21.2	18.2	20.1
Teciar	6.5	27.5	13.1	12.6
Totali 15-64	100.00	100.00	100.00	100.00

Tabela 16 ilustron që kërkesat për vende pune janë më të larta për pozita qeveritare, ku mbi gjysma e të gjithë të punësuarve (58.4 përqind) e kanë të përfunduar arsimin e lartë.

³³ Publikimi nga ASK "Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore TM4-2016"

Tabela 16: Niveli më i lartë arsimor sipas llojit të punëdhësit (15-64)

Niveli arsimor %	Sektori publik, qeveri	Ndërmarrje në pronësi shtetërore	Kompani private	Individ privat
Pa shkollë	0.0	0.3	0.1	0.0
Klasët I-IX	3.8	4.6	15.7	39.9
Arsim i mesëm profesional	28.2	28.7	42.2	41.4
Shkollë e mesme gjimnazi	9.6	20.0	24.6	15.2
Terciar	58.4	46.7	17.4	3.5
Totali 15-64	100.00	100.00	100.00	100.00

Në vitin 2016, shumica e të punësuarve kishin pozita pune në shërbime dhe shitje, në profesione elementare, si profesionistë dhe si punëtorë zejtarie (tabela 17).

Pothuaj, gjysma e femrave të punësuar ishin profesioniste, teknike dhe profesione që lidhen me të (40,7 përqind), 17,7 përqind ishin në shërbime dhe shitje dhe 15,4 përqind në profesione elementare. Meshkujt ishin më të shpërndarë në sektorë, por shumica ishin të punësuar në profesione elementare (24,0 përqind), 18,1 përqind punonin si punonjës në shërbime dhe shitje, 17,3 përqind si punëtorë zejtarie dhe punë që lidhen me të kurse 9,9 përqind ishin profesionistë (tabela 17).

Tabela 17: Profesione të punësuarve sipas gjinisë (%)

Profesionet e të punësuarve	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Ligjvënës, zyrtarë dhe menaxherë të lartë	8,1	5,1	7,5
Profesionistë	9,9	27,9	13,8
Teknikë dhe profesione të lidhura me ta	6,3	11,8	7,5
Nëpunës	4,5	9,4	5,5
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	18,1	17,7	18,0
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatarë	3,6	0,7	3,0
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	17,3	11,1	16,0
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	8,2	0,9	6,6
*Profesione elementare	24,0	15,4	22,1
Totali	100.00	100.00	100.00

Burimi: Publikimi nga ASK "Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore TMA-2016"

* Pozitat elementare përfshijnë pastrues dhe ndihmës, punëtorë të bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit, punëtorë të minierave, ndërtimit, prodhimit industrial, transportit, asistentë të përgatitjes së ushqimit, punëtorë të shitjeve në rrugë, punëtorët e pastrimit të mbetjeve urbane dhe punëtorë të tjerë elementarë.

Zonat Ekonomike në Kosovë³⁴

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, nën mandatin e saj ka edhe zhvillimin e sektorit privat, duke përfshirë edhe sektorin për zhvillimin e zonave ekonomike.

Zonat ekonomike në Kosovë janë të rregulluara me Ligjin për zona ekonomike, nr. 04/L-159, të shpallur në gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 6/12 mars 2013, Prishtinë, si dhe me UA 01/2014, UA 02/2014, UA 03/2014, UA 15/2016, si dhe me UA të Qeverisë nr. 03/2014, në përkufizimet e veta përfshinë Zonën e lirë, Park Industrial, Park Teknologjik, dhe Inkubatorët e Biznesit. Me këtë ligj përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e zhvilluesve, përdoruesve / operatoreve dhe të subjekteve të tjerë që ushtrojnë aktivitete në lidhje me zona ekonomike, llojin e veprimtarive që kryhen brenda zonave ekonomike, mënyrën e lëvizjes së mallrave nëpër to, dhe lehtësirat fiskale të parashikuara. Zonat ekonomike janë një komponentë e programit të hapësirave të punës dhe nënkupton ndërtimin e një infrastrukturë fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve.

Andaj bazuar në legjislacionin e lartëcekur janë gjashtë zona ekonomike të krijuara, respektivisht:

Parku i Biznesit në Drenas, Parku i Biznesit në Mitrovicë, Parku Teknologjik në Shtime, Parku Industrial në Frashër – Mitrovicë, Agro Zona Industriale në Suharekë, Parku Industrial në Lipjan si dhe dy (2) Zona ekonomike Gjakovë dhe Prizren.

Parku i Biznesit në Drenas, është krijuar në vitin 2010 me një sipërfaqe prej 24 ha. Ka përfunduar ndërtimi i infrastrukturës fizike (rrugët, energjia elektrike, ujësjellësi, kanalizimi, etj) si dhe janë të vendosura 40 biznese me veprimtari të ndryshme biznesore, duke filluar nga prodhimet farmaceutike, prodhimin e liftave, metalpunues, sektori i drurit, paneleve të ndryshëm e deri tek riciklimi i plastikës. Ndërtimi i infrastrukturës fizike është investim nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht nga KIESA.

³⁴ KIESA / http://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1_64

Parku i Biznesit në Mitrovicë, është krijuar në vitin 2012 me sipërfaqe prej 3.5 ha. Momentalisht është i plotësuar me 20 biznese të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore.

Parku Teknologjik-Shtime është krijuar në vitin 2013 me një sipërfaqe prej 10.70 ha. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me komunën e Shtimes ka bashkë investuar në rregullimin/ndërtimin e infrastrukturës fizike dhe është në fazën e finalizimit të komplet infrastrukturës fizike. Janë të vendosura dy biznese të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre biznesore dhe tri biznese të tjera në fazën e kontraktimit.

Parku Industrial në Frashër - Mitrovicë, është krijuar në vitin 2014, me sipërfaqe prej 48 ha. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në bashkëpunim me komunën ka investuar në rregullimin e një pjesë të infrastrukturës fizike konkretisht në nivelizimin e terrenit. Në vitin 2016 investimet janë duke vazhduar nga ana e komunës së Mitrovicës. Planifikohet që edhe në vitet vijuese MTI të vazhdojë me bashkë investim dhe finalizim të infrastrukturës fizike.

Zona Agro - Industriale në Suharekë, është krijuar në vitin 2015, me sipërfaqe prej 28 ha. Në vitin 2015 ka filluar investimin e parë në këtë zonë ekonomike, fillimisht në energji elektrike dhe ujësjellës. Në zonën ekonomike respektivisht "Agro - Zonën Industriale" aktualisht janë nënshkruar tri (3) kontrata si dhe me pesë (5) përfitues të tjerë janë në fazën e nënshkrimit të kontratave. Edhe gjatë këtij viti është duke vazhduar me investime në infrastrukturës fizike. Planifikohet që edhe në vitet vijuese MTI të vazhdojë me bashkë investim dhe finalizim të infrastrukturës fizike.

Parku Industrial në Lipjan është krijuar në vitin 2016, me një sipërfaqe prej 56 ha. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë së bashku me komunën e Lipjanit ka filluar investimin në rregullimin e infrastrukturës fizikë në këtë zonë ekonomike - faza e parë. Planifikohet që edhe në vitet vijuese MTI të vazhdojë me bashkë investim dhe finalizim të infrastrukturës fizike.

Ndërsa, zona ekonomike në Prizren dhe Gjakovë, për shkak të mos definimit të çështjeve pronësore ende nuk kanë filluar në punimet në ndërtimin e infrastrukturës fizike.

Përmbledhje rreth zonave të krijuara:

Totali i hapësirave të (6) zonave ekonomike të krijuara është rreth 170.20 ha.

Numri i bizneseve / investitorëve të vendosura në zonat ekonomike është 80 biznese. Zhvilluesit e zonave ekonomike (komunat) janë në fazën e kontraktimit të bizneseve të tjera për t'u vendosur në zonat ekonomike deri në plotësimin e të gjitha kapaciteteve që kanë këto zona ekonomike.

Vepribtaritë që ushtrohet në hapësirat e zonave ekonomike janë nga me të ndryshmet, si: metalpunues, përpunim të plastikes, letrës, prodhime nga druri, prodhime farmaceutike, liftave (ashensorëve), përpunimin e pemëve dhe perimeve etj.

Numri i punëtorëve që janë duke punuar në bizneset që janë të vendosura në zonat ekonomike është rreth 600 - 700 punëtorë.

Dhënia e hapësirave në shfrytëzim, hapësirat në kuadër të zonave ekonomike jepen në shfrytëzim të bizneseve për një periudhë deri në 99 vite, si dhe me procedurë të lehtësuar si në nivel komunal dhe në atë qendror.

Iniciativa të reja për krijimin e zonave ekonomike

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka iniciuar procedurat për krijimin Zonës Industriale përball Parkut të Biznesit në Drenas dhe deri me tani është përgatitur elaborati i shpronësimit. Zona Industriale në fjalë parasheh një hapësirë mbi 60 hektar, e cila mund të lidhet me Parkun e Biznesit në Drenas dhe mund të krijohet një hapësirë afër 90 hektarë në qendër të Kosovës.

Po ashtu janë disa iniciativa edhe nga Komunitet e Kosovës, si ajo e Vitisë, Vushtrrisë, etj.

Platforma e dialogut në mes Qeverisë dhe investitorëve

- ✓ Qeveria e Kosovës ka themeluar Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik (KKZHE), roli i të cilit është të organizojë dhe harmonizojë aktivitetet e institucioneve shtetërore me qëllim të eliminimit të barrierave dhe adresimit të sfidave të të bërit biznes në Republikën e Kosovës që ndikojnë në përmirësimin e ambientit për biznes dhe investimeve në Republikën e Kosovës.
- ✓ Këshilli Kombëtar për Investime (KKI) është themeluar nga Qeveria e Kosovës dhe ka për qëllim koordinimin e procesit të financimit të projekteve infrastrukturore në

Kosove, dhe të siguroj sinergji në mes të burimeve të ndryshme të financimit, përkatësisht buxhetit, huave dhe granteve.

Gjithashtu, disa dokumente strategjike të cilat i ka hartuar Qeveria e Kosovës lidhur me zhvillimin ekonomik të vendit dhe tërheqjen e investitorëve të huaj, janë si në vijim:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim si dokumenti kyç që paraqet prioritetet e larta qeveritare, ku edhe përfshihen masa që ndikojnë në tregti;
- ✓ Agjenda për Reforma Ekonomike, agjenda e reformave kyçe e dakorduar nga ana e Kryeministrit të Kosovës dhe Komisionerit të BE-së z. Hahn.
- ✓ Programi i Reformave Ekonomike – dokument i cili paraqet 20 masa kyçe që shërbejnë në thellimin e dialogut ekonomik në mes të Kosovës dhe BE-së.

Në Kosovë është i themeluar Këshilli i Investitorëve Evropian (KIE) që nga viti 2014.³⁵

Qëllimi i themelimit të këtij Këshilli është:

- a) të kontribuojë në përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe investimeve në Kosovë përmes një dialogu të hapur, konstruktiv dhe të qëndrueshëm me autoritetet e Kosovës në të gjitha nivelet;
- b) të mbështes përshtatjen e legjislaclonit kosovar në procesin e integrimit të Kosovës në BE, duke siguruar inpute bazuar në përvojën e vendeve të ndryshme të BE-së,
- c) të sigurojë një forum përmes të cilit anëtarët e tij mund të shprehin mendimet e tyre, krahasojnë përvojat, kërkojnë përgjigje për problemet e përbashkëta, të identifikojnë praktikatat më të mira, dhe të koordinojnë qasje të përbashkët në dialogun me autoritetet e Kosovës;
- d) të përfaqësoj, promovoj dhe avokoj qëndrimet e përbashkëta dhe interesat e anëtarëve të saj me synimin që të lehtësojnë pengesat potenciale në të bërit biznes, që si rrjedhojë do të rezultojnë në rritjen e investimeve të huaja direkte;
- e) të krijojë marrëdhënie dhe të bashkëpunojë me akterët e tjerë relevant, duke përfshirë organizatat ndërkombëtare, organizatat e tjera afariste, përfaqësitë diplomatike dhe organizatat të ngjashme të investitorëve të huaj në rajon, në funksion të ndarjes së praktikave më të mira dhe të promovimit të interesave të përbashkëta.

³⁵ <http://www.eic-ks.eu/>

Storie të suksesit dhe dështimit

- Qendra për thirrje "IQ to Link" me investitor gjerman - është ofrues i shërbimeve që vepron në bazë të standardeve evropiane për mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave. Kompania është regjistruar në Kosovë në vitin 2015 dhe tashmë ka punësuar rreth 200 të rinj nga 400 që është parashikuar të punësohen në këtë linjë të shërbimit.³⁶ Përveç selisë në Prishtinë, IQ to Link ka hapur zyret edhe në qytetin e Prizrenit. Në këtë pikë kompania numëron 45 punëtorë.³⁷
- Kompania Philippos Food Kosovo L.L.C. degë e kompanisë "Philippos Holding GmbH & Co" me investitor gjermano-kosovar - e cila veprimtarinë e saj kryesore e ka përpunimin e produkteve ushqimore si mbjelljen, kultivimin dhe përpunimin e perimeve, është në rrugëtim të mirë në ngritjen e ekonomisë në Kosovë, si dhe në pavarësimin financiar të grave. Kjo kompani ka arritur që në fazën e parë të punësojë 600 punëtorë, numër ky që është në vazhdimësi në rritje. Numëri më i madh i të punësuarve janë gra.³⁸
- "ABIDAT" dhe "Imbus AG" janë kompani që merren me teknologji informative. Këto dy kompani gjermane sollën biznesin e tyre edhe në Kosovë. Më 15 Janar 2016 ABIDAT filloi punën në Prishtinë. Kjo kompani ka gjithsej 12 punëtorë. Aktualisht projekti i tyre ka të bëjë me këshillim dhe zhvillim të disa projekteve me rëndësi të madhe si dhe projektin kryesorë atë të kompanisë së njohur gjermane "SIEMENS". Gjithashtu programerët nga Kosova krijojnë softuer që përdorën në mjete të transportit si vetura, tren etj. Planet e afërta të kompanisë së IT-së janë të rrisin numrin e stafit të tyre, ku deri në vitin 2017 planifikojnë të kenë deri në 20 punëtorë. Kompania "Imbus AG" është kompani gjermane e cila merret me testimin dhe vlerësimin në mënyrë profesionale të softuerëve. Selia e "Imbus AG" në qytetin e Pejës ka filluar punë në muajin korrik të 2016-tës. Përqindja me mbi 50% të të punësuarve femra në fushën e IT-së në selinë e kompanisë e tij në Pejë, si dhe motivimi i madh i të rinjve kosovarë ka bërë që Rossner të ngelet i habitur me këtë fakt. Andaj, ai është i kënaqur me këtë investim.³⁹

³⁶ <http://telegrafi.com/hapet-zyrtarisht-ne-prishtine-qendra-per-thirrje-iq-to-link-synon-te-punesoje-deri-ne-430-persona-foto/>

³⁷ http://www.pristina.diplo.de/Vertretung/pristina/sq/05/01_20Wirtschaft/seite-iq-to-link.html

³⁸ http://www.pristina.diplo.de/Vertretung/pristina/sq/05/01_20Wirtschaft/seite-jeha-company.html

³⁹ http://www.pristina.diplo.de/Vertretung/pristina/sq/05/01_20Wirtschaft/seite-it-unternehmen.html

Ndërsa, si storie dështimi mund të ceket rasti i një kompanie turke⁴⁰ e cila ka qenë e interesuar të investojë në Kosovë por për shkak se nuk ka pasur incentivë tatimore si psh pushime tatimore, është tërhequr nga investimi në Kosovë.

Pengesat gjatë procesit të investimit në Kosovë

Duke e ditur rëndësinë e investimeve të huaja për zhvillimin ekonomik të vendit, jo çdoherë Kosova është cilësuar si destinacion ideal për të investuar për shkak të disa pengesave si: procedurat burokratike; korrupsioni&nepotizmi; mjedisi politik; infrastruktura fizike; sistemi i dobët arsimor; administratë publike jo-efikase; shkallë e lartë e ekonomisë jo-formale; sistem gjyqësor jo-efikas.⁴¹

Pengesa tjera të hasura gjatë procesit të investimit janë edhe: përqindjet e larta të kamatave; mungesa e informatave për mundësitë e investimeve në Kosovë; çmimi i lartë i rrymës elektrike për sektorin e biznesit dhe furnizimi jo i rregullt; konkurrenca jo e drejtë me referencë specifike ndaj kompanive në veri të Kosovës të cilat nuk paguajnë taksa e as energji elektrike dhe si rezultat dalin me çmime shumë të ulëta; mungesa e stafit të kualifikuar sidomos në lidhje me industrinë; mungesa e subvencioneve për sektorët që mbrojnë mjedisin; mbrojtja e dobët e investimeve nga shteti; mungesa e stimuljeve financiarë; mungesa e arkave fiskale të një numër i pompave të benzinës; efikasitet i dobët i lëshimit të lejeve të ndërtimit; taksat të merren pasi të fitohen të hyrat dhe jo më parë; zbatimi i pakënaqshëm i kontratave. Partnerët e tyre të biznesit në Kosovë shpeshherë nuk i përmbushin detyrimet e tyre (p.sh. të investojnë), duke shkaktuar kështu probleme të mëdha për investorët e huaj.⁴²

Trajtimi serioz i gjitha këtyre pengesave të identifikuar nga aktet relevant që do të rezultojnë me zgjidhje konkrete do të dërgonte një sinjal pozitiv te investorët potencial për të investuar në Kosovë dhe te investorët ekzistues që të zgjeronin aktivitetin e tyre afarist.

⁴⁰ Për hir të konfidencialitetit, nuk do të përmendet emri i kompanisë.

⁴¹ Sytrime Dervishalli "Opportunities to Foreign Investment in Kosovo", September 2011, pg-35-36

⁴² Raporti "Lehtësimi i investimeve të diasporës në Kosovë" IOM&UNDP

Kontaktet me rëndësi

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)

Adresa: Muharrem Fejza P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 200 36542, +381 (0) 38 200 36585
E-Mail: info.kiesa@rks-gov.net
Website: <https://kiesa.rks-gov.net>

Dogana e Kosovës

Adresa: P.O. Box 000, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 540 350
E-Mail: info@dogana-rks.net
Website: <https://dogana.rks-gov.net/en/>

Administrata Tatimore e Kosovës

Adresa: Dëshmorët e Kombit dhe Bill Clinton P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 200 250 25
E-Mail: info@atk-ks.org
Website: <http://www.atk-ks.org/?lang=en>

Banka Qendrore e Kosovës

Adresa: Garibaldi Nr. 33, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 222 055 107
E-Mail: info@bqk-kos.org
Website: <https://www.bqk-kos.org/?m=t&id=1>

Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

Adresa: Muharrem Fejza P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 512 791
E-Mail: info@arbkrks-gov.net
Website: <https://arbkrks-gov.net/page.aspx?id=2.1>

Agjencia për Pronësi Industriale

Adresa: Muharrem Fejza P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 512 207
E-Mail: isa.duka@rks-gov.net
Website: <http://www.itg-rks.com/en-us/The-Industrial-Property-Office>

Departamenti i Tregtisë

Adresa: Muharrem Fejza P.N., 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0) 38 200 36 623
E-Mail: sytrime.dervisholli@rks-gov.net
Website: <https://mti.rks-gov.net/>

Oda Ekonomike Kosovës

Adresa: Nëna Tereze Nr.20, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 224 299

E-Mail: info@oek-kcc.org

Website: <https://www.oek-kcc.org/En/>

Oda Ekonomike Gjermano – Kosovare

Adresa: Ali Hadri, P.N. Capital Gate, Katë 5, 12000 Fushë Kosovë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 600 880

E-Mail: info@oegjk.org

Website: <http://www.oegjk.org/oegjk/>

Referencat

Literaturë

Sytrime Dervisholli (2011), *"Opportunities to Foreign Investment in Kosovo"*, Rochester Institute of Technology & American University in Kosovo

Burime Elektronike

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018

Dogana e Kosovës, www.dogana-ks.org/tarik/

Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2016-2021)

Agjencia e Regjistrimit të bizneseve në Kosovë, www.arbk.rks-gov.net

USAID&ARBK "Indikatorët bazë të performances për regjistrimin e bizneseve në Kosovë", Tetor 2016

UNCTAD World Investment Report 2016

Banka Qendrore e Kosovës – buletini mujor statistikor, Tetor 2016

FMN, Report for selected countries and subjects

Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë, http://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1_30

Administrata Tatimore e Kosovës, <http://www.atk-ks.org/7422-2/#>

Kuvendi i Kosovës, <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/llogjet/04-L-220%20sh.pdf>

Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë, <http://www.invest-ks.org/sq/Legjislacioni-dhe-Marreveshjet>

World Bank Doing Business Report,
<http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/kosovo>

World Trade Organization, www.wto.org

Gazeta Zyrtare e Kosovës, <http://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=1&InstID=1&CatID=6>

Kuvendi i Kosovës, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,518>

http://www.partneretsocial.org/uploads/files/2014/June/20/Ligji_i_Punes_ne_Kosove1403267101.pdf

Kuvendi i Kosovës, <http://www.assembly-kosova.org/?cid=1,191,349>

Kuvendi i Kosovës, <http://www.kuvendikosoves.org/?cid=1,191,342>

Ministria e Pushtetit Lokal, <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/b398d99f-918f-4096-886a-ba9d28820ee2/Projektiligji-per-ndryshimin-dhe-plotesimin-e-Ligji.aspx>

Kuvendi i Kosovës,
<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20marredheniet%20e%20detyrimeve.pdf>

Agjencia për Pronësi Industriale, <http://kipa.rks-gov.net/>

Ministria e Kulturës, <http://www.mkrs-ks.org/?page=1,157>

Banka Qendrore e Kosovës, <http://www.bqk-kos.org/?id=55>

Shoqata e Bankave në Kosovë, <http://bankassoc-kos.com/sektori-bankar/ligjet-perkatese>

Shoqata e Bankave në Kosovë, <http://bankassoc-kos.com/sektori-bankar>

Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë, <http://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,28>

Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë, <http://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,29>

Publikimi nga ASK "Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2015 në Kosovë / Qershor 2016"

Agjencia për Përkrahjen e Investimeve dhe Ndërmarrjeve në Kosovë, <http://kiesa.rks-gov.net/page.aspx?id=1.64>

Këshilli i Investitorëve Evropian në Kosovë, <http://www.eic-ks.eu/>

Portal vendor, <http://telegrafi.com/hapet-zyrtarisht-ne-prishtine-qendra-per-thirrje-iq-to-link-synon-te-punesoje-deri-ne-430-persona-foto/>

Ambasada e Gjermanisë në Kosovë,
http://www.pristina.diplo.de/Vertretung/pristina/sq/05/01_20Wirtschaft/seite-iq-to-link.html

Ambasada e Gjermanisë në Kosovë,
http://www.pristina.diplo.de/Vertretung/pristina/sq/05/01_20Wirtschaft/seite-jaha-company.html

Ambasada e Gjermanisë në Kosovë,
http://www.pristina.diplo.de/Vertretung/pristina/sq/05/01_20Wirtschaft/seite-it-unternehmen.html

